



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:093055

Datë: 02.12.2020

Numri i dokumentit: 01314601

P.nr.491/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Rilind Sermaxhaj, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Eronita Llapashtica, në çështjen penale kundër të pandehurit J. D nga ..., për shkak të veprës penale dhuna në familje nga neni 248 paragrafi 3, nën paragrafi 3.1 dhe 3.2 lidhur me nenin 77 të KPRK-ës, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan me numër PP.II.nr.1105/2020, të datës 27.07.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe jo publik me datë 18.11.2020, mori dhe shpalli ndërsa me datë 02.12.2020 përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri J. D nga babai A... dhe nëna F..., e lindur Xh..., i lindur me datë ..., në ... ku edhe jeton në lagjen ..., rruga "...", numër 7, ka të kryer klasën e dy vite të shkollës së mesme, i pa martuar, baba i një fëmije, i pa punë, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 16.07.2020 rreth 18:30 në ... në rrugën “...” në shtëpinë e përbashkët familjare, në ambient familjar, i pandehuri, ka ushtruar dhunë në familje, ndaj viktimës së ndjeshme, të dëmtuarës B. M, me të cilën ka bashkëjetuar rreth tre vite, në kundërshtim me nenin 2, nën paragrafi 1.2 të Ligjit për Dhunë në Familje, duke ushtruar dhunë fizike dhe psikike, ashtu që i pandehuri posa është kthyer nga puna, i është drejtuar të dëmtuarës me fjalët: “kush e ka thy këtë zog në oborr” souvenir i gurit, pastaj i është drejtuar duke i thënë: “A po kcen vet pi ballkonit mu myt a pot gjuj une” dhe posa kanë hy brenda në shtëpi, ka filluar ta godas me grushte nëpër fytyrë dhe kokë, ku nga goditjet e dëmtuara është rrëzuar në tokë, ku edhe ashtu e shtrirë në tokë, i pandehuri e ka goditur me grushte nëpër tërë trupin, e duke e kërcënuar me fjalët “skam et shku ty shumë larg” dhe përsëri ditën e nesërme me datë ..., posa është kthyer nga puna i pandehuri, ka filluar ta ofendoj me fjalë të ndryshme si dhe duke e goditur me grushte fytyrës dhe kokës, me çka i pandehuri në vazhdimësi me veprimet e tij, ka ushtruar dhunë fizike dhe psikike, duke e cenuar rëndë dinjitetin e të dëmtuarës.

-Me çka ka kryer veprën penale dhuna në familje nga neni 248 paragrafi 3, nën paragrafi 3.1 dhe 3.2 lidhur me nenin 77 të KPRK-ës.

andaj, gjykata në bazë të nenit 4,38,39,40,43,46,47,48,49,69,70,71 dhe 72 të KPRK-ës dhe neneve 248 e 365 të KPP-ës, të pandehurin J.D

E GJYKON

Me dënim me gjobë në shumë prej 400 € (katërqind euro), si dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 120 (njëqindnjëzet) ditësh, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i pandehuri në periudhën verifikuese prej 1 (një) viti nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

Obligohet i pandehuri që të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 20 € (njëzetë euro), si dhe shumën prej 30 € (tridhjetë euro) për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

A R S Y E T I M

1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, me datë 27.07.2020, ka ngritur aktakuzën me numër PP.II.nr.1105/2020, kundër të pandehurit J.D nga ... për shkak të veprës penale dhuna në familje nga neni 248 paragrafi 3, nën paragrafi 3.1 dhe 3.2 lidhur me nenin 77 të KPRK-ës.

Me datë 18.11.2020, pranë kësaj gjykate është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar dhe jo publik në të cilën ishin prezent prokurori i shtetit Leonora Kadriu, e dëmtuara B. M si dhe i pandehuri J. D. Në këtë seancë pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit, e njëjta ka bërë ricilësimin juridik të veprës penale nga paragrafi 1 i nenit 248 të KPRK-ës siç ishte ngritur akti akuzues në paragrafin 3 nën paragrafin 3.1 dhe 3.2 të nenit 248 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, dhe pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit i pandehuri i lartcekur kishte deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe, e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale e cila i vihet në barrë, me ç'rast gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 248 të KPP-ës ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë nga ana e të pandehurit.

2.Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjykata pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në të cilin kanë qenë palët e lartcekura, pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit për veprën penale për të cilën akuzohet ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë në kuptim të nenit 248 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1-1.4 të KPP-së dhe se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit nuk është kundërshtuar nga ana e palëve prezente. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e

çështjes të cilat i përmban aktakuza përkatësisht ky pranim i fajësisë gjen mbështetje në provat materiale të cilat i janë bashkangjitur aktakuzës siç janë: raporti fillestar i incidentit me numër të rastit 2020-CA-0742 i datës 19.07.2020, deklarata e të dëmtuarës B. M deklarata e të pandehurit J. D raporti i zyrtarit policor, foto dokumentacioni, kërkesa për urdhër mbrojtje për të dëmtuarën e datës 21.07.2020, të dhënat nga data-baza e policisë për të pandehurin si dhe shkresat e tjera të lëndës gjithashtu gjykata me rastin e pranimit të fajësisë ka gjetur se aktakuza lëndore nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se i pandehuri J.D ka kryer veprën penale dhuna në familje nga neni 248 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 dhe 3.2 lidhur me nenin 77 të KPRK-ës, në kohën, vendin, dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4.Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të pandehurit duhet ti shqiptohet dënim me gjobë në shumë prej 400 € (katërqind euro), si dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 120 (njëqindnjëzet) ditësh, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i akuzuari në periudhën verifikuese prej 1 (një) viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të kryesit gjithashtu gjykata me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 69,70,71, dhe 72 të KPRK-së ashtu që rrethanë lehtësuese për të pandehurin gjykata ka marrë faktin se i njëjti ka pranuar fajësinë për veprën penale të cilën i vihen në barrë në një fazë të hershme të procedurës penale përkatësisht i njëjti në çdo fazë të procedurës penale e ka pranuar fajësinë për veprën e lartcekur, i njëjti është penduar dhe ka shfaqur keqardhje për veprimet e tij të cilin gjykata e mori si pendim real, i njëjti i ka kërkuar falje edhe të dëmtuarës, ka premtuar që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe as vepra të tjera penale, faktin se tani i pandehuri dhe e dëmtuara kanë raporte normale dhe nuk kanë probleme sa i përket kontaktit të fëmijës së tyre të përbashkët i cili i është besuar të pandehurit për mbajtje, po ashtu gjykata ka marrë parasysh edhe rrethanat personale dhe karakterin e të pandehurit ku nga shkresat e lëndës shihet se për të pandehurin është hera e parë që i njëjti bie ndesh me ligjin, përkatësisht i njëjti më parë nuk ka qenë i gjykuar e as dënuar për çfarëdo vepre penale, i njëjti është mbajtës i familjes, i papunë dhe njëkohësisht është mbajtës i familjes përfshirë këtu edhe fëmijën e mitur nga martesë me të dëmtuarën B. M si dhe faktin se nga shkresat e lëndës shihet se për të pandehurin kjo është hera e parë që i njëjti bie ndesh me ligjin përkatësisht i njëjti më parë nuk ka qenë i gjykuar e as dënuar për ndonjë vepër penale me aktgjykim të formës së prerë ndërsa si rrethanë rënduese për të pandehurin gjykata mori dashjen e të pandehurit për ta kryer veprën penale për të cilën është shpallur fajtor pasi që i njëjti në vazhdimësi me veprimet e tij ka ushtruar dhunë fizike dhe psikike duke e cenuar rëndë dinjitetin e të dëmtuarës siç përshkruhet në dispozitivin e këtij aktgjykimi andaj bazuar në të lartcekurat gjykata konsideron se me dënimin e shqiptuar si në

dispozitiv të këtij aktgjykimi mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

5. Vendimi lidhur me realizimin e kërkesës pasurore juridike

Duke pasur parasysh deklarin e të dëmtuarës B. M se e njëjta nuk parashtron kërkesë pasurore juridike si dhe nuk i bashkangjitet ndjekjes penale ndaj të pandehurit gjykata rrjedhimisht edhe nuk vendosi lidhur me kërkesën pasurore juridike.

6. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të akuzuarit, gjykata duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që të akuzuarit ta detyrojë ta paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 20 € (pesëdhjetë euro) si dhe në emër të ligjit për kompensimin e viktimave shumën prej 30 € (tridhjetë euro), të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.491/2020, me datë 02.12.2020

Zyrtarja Ligjore,
gjkues,
Eronita Llapashtica
Sermaxhaj

Gjyqtari i vetëm

Rilind

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj gjykate themelore.